



**AKT THEMELIMI  
I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR  
"Tech Studio" Sh.p.k.**

Sot, me date 09.03.2022, në Tirane, është e pranishme:

- Shoqëria **Grapho s.r.l.**, shoqëri e te drejtës italiane, e regjistruar në regjistrin e shoqërive të Milano, me IVA 01147141004, kod fiskal n. 02996240582 Numri Rea: 423784, me seli në Itali, në Romë, via Mario De Fiori n. 66, përfaqësuar nga administratori i vetëm Z. Pietro Corradini, shtetas italian, lindur në Ancona, Itali, më datë 14/10/1951, sipas vendimit të Asamblesë të ortakëve të Grapho s.r.l. date 25.01.2022 që bashkëlidhet, ky i fundit përfaqësuar nga Av. Ervin Bano, shtetas Shqiptar, lindur në Vlorë, më atë 21.07.1977, me numër personal H70721130E, në bazë të prokurës noteriale date 26.01.2022, me rep. n. 19654, që bashkëlidhet ka vendosur të nënshkruajë Aktin e Themelimit të mëposhtëm të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar (më poshtë "Shoqëria"), aktiviteti i së cilës rregullohet nga legjislacioni shqiptar në fuqi dhe Statuti i saj, i cili është pjesë përbërëse e këtij akti, së cilës i bashkëngjitet (më poshtë "Shtojca 1").

**Neni 1 - Emërtimi**

Emërtimi i Shoqërisë është "Tech Studio" Sh.p.k.

**Neni 2 - Selia**

Selia e Shoqërisë është në Rruga Abdi Toptani, Torre Drin, Kati 2, 1001-Tiranë, Shqipëri.

**Neni 3 – Objekti i shoqërisë**

- 3.1 Shoqëria ka për objekt kryerjen e aktiviteteve tregtare në përputhje me legjislacionin Shqiptar në fuqi.
- 3.2 Shoqëria ka si objekt kryesor:
- a. Disenjim software-i duke përfshirë analizën e kërkesave të sistemit software, projektimin e arkitekturës dhe projektimin e detajuar të sistemit software;
  - b. Zhvillim dhe mirëmbajtje sistemesh software duke përfshirë programimin e sistemeve software, kodimin, instalimin, integrimin e të gjithë komponentëve, dokumentimin, identifikimin dhe korrigjimin e gabimeve, modifikimet (pas momentit që software-i është vendosur në operim), mirëmbajtja e të gjithë komponentëve, suporti i sistemit si një tërësi komponentësh, që, në funksionimin e tyre, realizojnë qëllimin e zgjidhjes informatike;
  - c. Testim software duke përfshirë testimin e funksionaliteteve, të ngarkesës në punë, të performancës, të pranimit, të disponueshmërisë dhe të sigurisë së sistemit software;
  - d. Disenjim dhe zhvillim sistemesh të komunikimit duke përfshirë analiza, planifikimin, projektimin, zbatimin, vendosjen në punë dhe mirëmbajtjen e sistemeve të komunikimit të rrjeteve të pajisjeve informatike (LAN/ WAN/ WLAN/ MAN/ SAN/ CAN);
  - e. Disenjim dhe zhvillim sistemesh të sigurisë duke përfshirë analiza të kërkesave të sigurisë së klientit, projektimin e arkitekturës, instalimet dhe konfigurimet e komponentëve, vendosjen në punë, testimet e sigurisë dhe mirëmbajtja përkatëse;
  - f. Zhvillim sistemesh migrimi duke përfshirë transferimin e të dhënave dhe infrastrukturës përkatëse nga një teknologji e vjetër në një teknologji të re;
  - g. Përmirësim/upgrade sistemesh informatike;
  - h. Operimi, menaxhimi, suporti i përdorimit, trajnimi dhe auditimi teknik/informatik për sistemet software.
- 3.3 Shoqëria mund të kryejë çdo transaksion tregtar, industrial, financiar, me pasuri të luajtshme dhe të paluajtshme që konsiderohet i nevojshëm, i dobishëm apo i përshtatshëm, për arritjen e qëllimit të shoqërisë siç është specifikuar më sipër, duke përfshirë, por pa u kufizuar në, lëshimin e garancive dhe të garancive reale; lidhjen e kontratave të financimit të çdo lloji, edhe në formën e lisingut; lidhjen e kontratave të qiradhënies për asetet, pronat ose qiradhënie të të gjitha

pjesëve te ndërmarrjes dhe/ose njësi te veçanta te saj që veprojnë në sektorët e lartpërmendur; blerjen, shitjen ose përdorimin e patentave të palëve të treta; marrja përsipër dhe dhënien e mandateve per agjenci, përfaqësi, agjent, koncesionar; dhe çdo aktivitet tjetër që here pas here mund të jetë konsideruar i nevojshëm, i dobishëm ose i përshtatshëm për qëllimet e mësipërme, në kufijtë e dispozitave ligjore në fuqi. Shoqëria mund të marrë pjesë ne tenderë publik, shitje ne ankand dhe gara private. Ajo mund të marrë përsipër, si drejtpërdrejtë ashtu edhe indirekt, interesa, kuota, pjesëmarrje dhe aksione, në shoqëri të tjera, shoqata, konsorciume ose ndërmarrje, që kanë për objekt, analog, të ngjashëm ose të lidhur me objektin saj në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi. Të gjitha këto aktivitete do të kryhen gjithsesi në kufijtë dhe në respekt të dispozitave ligjore qe rregullojnë ushtrimin e tyre; në veçanti operacionet e natyrës financiare duhet të kryhen në respekt të plotë me dispozitat ligjore te kohës duke përjashtuar mbledhjen e fondeve në publik, në çfarëdo lloj forme.

#### **Neni 4 - Kohëzgjatja**

Kohëzgjatja e veprimtarisë së Shoqërisë do të jetë me një afat të pacaktuar.

#### **Neni 5 – Kapitali themeltar**

- 5.1. Kapitali themeltar i shoqërisë është ALL 254,000.00 (dyqindpesëdhjetëekatërmijë leke).
- 5.2. Kapitali themeltar i shoqërisë përbëhet nga 1 (nje) kuote, e nënshkruar, me vlerë nominale sipas kontributit te ortakut ne kapitalin themeltar te Shoqërisë percaktuar ne nenin 7 (shtate) te Statutit.

#### **Neni 6 - Kontributet**

- 6.1 Kontributi në kapitalin e shoqërisë është ofruar si më poshtë:
  - Shoqëria Grapho s.r.l ofron një kontribut në para të barabartë me ALL 254,000.00 (dyqindpesëdhjetëekatërmijë leke), nëpërmjet depozitimit te kësaj shume pranë llogarisë bankare në emër të shoqërisë në themelim e sipër.
- 6.2 Sipas kontributeve të mësipërme:
  - Shoqërisë Grapho s.r.l i përket një kuotë, me vlere nominale ALL 254,000.00 (dyqindpesëdhjetëekatërmijë leke), që i korrespondon 100% (njëqind për qind) të kapitalit të Shoqërisë.

#### **Neni 7 – Transferimi i kuotave**

Kuotat i transferohen të tretëve sipas parashikimeve të Statutit.

#### **Neni 8 – Administrimi**

- 8.1 Me këtë akt emërohet 1 (një) Administratorë i Shoqërisë personi si më poshtë:
  - Znj. Adelina Beqiri, lindur ne Tirane, me 29-10-1995, me banim ne Tirane, Farke, Rruga e Korabit N. 4, me numer personal M11608011T.
- 8.2 Administratori do të ushtrojë të gjitha kompetencat e administrimit të zakonshëm, në përputhje me parashikimet e nenit 14.2 të Statutit.
- 8.3 Administratorit i jepen të gjitha kompetencat e nevojshme për të kryer të gjitha formalitetet dhe veprimet e parashikuara për themelimin e Shoqërisë sipas legjislacionit në fuqi. Për këtë qëllim, Administratori, mund t'u drejtohen për ndihmë të tretëve ose konsulentëve të cilëve mund të delegojnë në tërësi ose pjesërisht kryerjen e aktivitetit të sipërpërmendur.
- 8.4 Administratori është gjithashtu i autorizuar të veprojë në emër të Shoqërisë në formim e sipër deri në regjistrimin e saj pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit. Ai është gjithashtu i autorizuar, të firmosi të gjitha aktet dhe të marrë përsipër detyrime në emër të Shoqërisë që rrjedhin prej


momentit të regjistrimit të saj në Qendrën Kombëtare të Biznesit, brenda kufijve të përcaktuar në nenin 14.2 të statutit.

**Neni 9– Gjuha**

- 9.1 Ky Akt Themelimi është hartuar në 3 (tre) kopje në gjuhën shqipe me shtojcë përkthimin në gjuhën italiane.
- 9.2 Për të gjitha mosmarrëveshjet që mund të lindin në lidhje me interpretimin e akteve si më lartë, versioni në italisht do të jetë i vetmi version ligjërish detyrues.

\*\*\*


Per ORTAKUN E VETEM  
**Grapho s.r.l.**



Av. Ervin Bano  
Perfaqesues



PERKTHYES



**ATTO COSTITUTIVO  
DELLA SOCIETÀ A RESPONSABILITÀ LIMITATA  
"Tech Studio" SH.P.K.**

Oggi, 09.03.2022, in Tirana, e' presente la seguente parte:

- La Società **Grapho s.r.l.**, società di diritto Italiano, iscritta al registro delle imprese di Roma, con Partita IVA: 01147141004, codice fiscale n. 02996240582, R.E.A. n. 423784, con sede legale in Italia, in Roma, via Mario De Fiori n. 66, rappresentata ai fini del presente atto dall'amministratore unico sig. Pietro Corradini, cittadino italiano, nato ad Ancona, il 14/10/1951, secondo deliberazione dell'Assemblea dei soci di Grapho s.r.l del 25.01.2022 che si allega, quest'ultimo rappresentato dall'Avv. Avv. Ervin Bano, cittadino albanese nato a Vlore il 21.07.1977, con numero personale H70721130E, in base alla procura notarile del 26.01.2022 con rep. n. 19654, che si allega,

ha deciso di stipulare il seguente Atto Costitutivo di una società a responsabilità limitata, (di seguito "**Società**") la cui attività verrà regolata dalla legislazione Albanese in vigore e dal suo Statuto che fa parte integrante di questo contratto, al quale è stato allegato (cfr. All. 1)

**Art. 1 - Denominazione**

La denominazione della Società è "Tech Studio" Sh.p.k.

**Art. 2 - Sede**

La sede legale della Società è stabilita in Rruga Abdi Toptani, Torre Drin, Kati 2, 1001 - Tirana, Albania.

**Art. 3 - Oggetto sociale**

- 3.1 La Società ha come oggetto sociale lo svolgimento delle attività commerciali in conformità con la legislazione albanese in vigore.
- 3.2 La Società ha per oggetto principale:
- a. Disegno di software compresa l'analisi dei requisiti di sistema software, la progettazione dell'architettura e la progettazione dettagliata di sistemi informatici;
  - b. Sviluppo e manutenzione di sistemi software compresa la programmazione di software di sistema, la codifica, l'installazione, l'integrazione di tutti i componenti, la documentazione, l'identificazione e la correzione degli errori, le modifiche (dopo che il software è stato messo in produzione), la manutenzione di tutti i componenti, il supporto del sistema come un insieme di componenti;
  - c. Test del software compresi i test delle funzionalità, del carico di lavoro, delle prestazioni, dell'acquisizione dei dati, della disponibilità e della sicurezza del sistema;
  - d. Progettazione e sviluppo di sistemi di comunicazione compresa l'analisi, la pianificazione, la progettazione, l'implementazione, la messa in produzione e la manutenzione di sistemi di comunicazione di reti informatiche di qualsiasi tipo;
  - e. Progettazione e sviluppo di sistemi di sicurezza compresa l'analisi dei requisiti di sicurezza del cliente, la progettazione architeturale, le installazioni e le configurazioni dei componenti, la messa in produzione, i test di sicurezza e la relativa manutenzione;
  - f. Sviluppo di sistemi di migrazione compreso il trasferimento di dati e della relativa infrastruttura da una vecchia tecnologia a una nuova tecnologia;
  - g. Miglioramento e/o aggiornamento di sistemi informatici;
  - h. Operatività, gestione, supporto agli utenti, formazione e audit tecnico e/o informatico per sistemi software.
- 3.3 La società potrà compiere ogni operazione commerciale, industriale, finanziaria, mobiliare ed immobiliare ritenuta necessaria, utile o anche solamente opportuna, per il conseguimento dell'oggetto sociale come sopra specificato, ivi incluso a titolo non esaustivo ma solo esemplificativo, il rilascio di garanzie, anche reali; la conclusione di contratti di finanziamento di qualunque tipo, anche nelle forme di leasing; la conclusione di contratti di locazione di cespiti o di immobili o di affitto anche di intere aziende e/o rami aziendali operanti nei settori sopra indicati; l'acquisto, la vendita o l'uso di brevetti di terzi; l'assunzione e la concessione di agenzie, rappresentanze, commissionarie,

concessionarie; e ogni altra attività che di volta in volta possa essere considerata necessaria, utile o opportuna ai fini predetti, nei limiti delle vigenti norme. Essa potrà, inoltre, partecipare a pubblici appalti, licitazioni e trattative private. Essa può inoltre assumere, sia direttamente che indirettamente, interessenze, quote, partecipazioni anche azionarie, in altre società, associazioni, consorzi o imprese, aventi oggetto, analogo, affine o connesso al proprio nel rispetto delle vigenti norme. Tutte tali attività andranno, comunque svolte, nei limiti e nel rispetto delle norme che ne disciplinano l'esercizio; in particolare le operazioni di natura finanziaria debbono essere svolte nel pieno rispetto della normativa per tempo vigente in materia restando, comunque, esclusa la raccolta del risparmio presso il pubblico, sotto qualsiasi forma.

#### **Art. 4 - Durata**

La durata della Società è stabilita a tempo indeterminato.

#### **Art. 5 - Capitale sociale**

- 5.1 Il capitale sociale è di ALL 254,000.00 (duecentocinquantaquattromila leke).
- 5.2 Il capitale sociale è composto da 1 (una) quota interamente sottoscritta, avente il valore nominale come da conferimento del socio nel capitale sociale, di cui al art. 7 (sette) del presente Statuto.

#### **Art. 6 - Conferimenti e quote**

- 6.1 Il conferimento del capitale sociale avverrà nel modo seguente:
- La società Grapho s.r.l., ha conferito in danaro ALL 254,000.00 (duecentocinquantaquattromila leke), mediante versamento di pari importo presso il conto corrente bancario intestato alla costituenda Società.
- 6.2 Secondo i conferimenti sopracitati:
- alla società Grapho s.r.l. appartiene una quota, di valore nominale pari a ALL 254,000.00 (duecentocinquantaquattromila leke) e corrispondente al 100% (cento per cento) del capitale sociale.

#### **Art. 7 - Trasferibilità delle quote**

Le quote sociali saranno trasferibili a terzi secondo le modalità previste dallo Statuto.


#### **Art. 8 - Amministrazione**

- 8.1 Con il presente atto viene nominato 1 (uno) Amministratore della Società come segue:
- Sig.ra Adelina Beqiri, nata a Tirana, il 29-10-1995, residente in Tirana, Farke, Rruga e Korabit N. 4, con numero personale M11608011T.
- 8.2 L'Amministratore potrà esercitare tutti i poteri di ordinaria amministrazione, in conformità con quanto previsto dall'articolo 14.2 dello Statuto.
- 8.3 All'Amministratore vengono conferiti tutti i poteri necessari per svolgere tutte le formalità e gli adempimenti previsti per la costituzione della Società secondo la legislazione e la normativa vigente. A tal fine, l'Amministratore potrà avvalersi dell'ausilio di terzi e di consulenti ai quali potrà delegare in parte o in tutto lo svolgimento delle suddette attività.
- 8.4 L'Amministratore e' altresì autorizzato ad agire in nome e per conto della costituenda Società fino alla sua registrazione presso il Centro Nazionale del Business. L'Amministratore e' autorizzato ad agire in nome della Società dal momento della sua registrazione presso il Centro Nazionale del Business, entro i limiti di cui all'art.14.2 dello statuto.


- 11
- Art. 9 – Lingua**
- 9.1 Il presente Atto Costitutivo è redatto in 3 (tre) copie in lingua albanese con annessa la traduzione in lingua italiana.
- 9.2 Per tutte le controversie che dovessero insorgere relativamente all'interpretazione dei predetti atti e documenti, la versione italiana sarà l'unica legalmente vincolante.

\*\*\*

Per Il SOCIO UNICO  
**Grapho s.r.l.**

  
Av. Ervin Bano  
Rappresentate

Interprete





**STATUTI**  
**I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR**  
**"Tech Studio" Sh.p.k.**

Sot, me date 09.03.2022, ne Tirane, është e pranishme:

- Shoqëria **Grapho s.r.l.**, shoqëri e te drejtës italiane, e regjistruar në regjistrin e shoqërive të Milano, me IVA 01147141004, kod fiskal n. 02996240582 Numri Rea: 423784, me seli në Itali, në Romë, via Mario De Fiori n. 66, përfaqësuar nga administratori i vetem Z. Pietro Corradini, shtetas italian, lindur në Ancona, Itali, më datë 14/10/1951, sipas vendimit të Asamblesë të ortakëve të Grapho s.r.l. date 25.01.2022 që bashkëlidhet, ky i fundit përfaqësuar nga Av. Ervin Bano, shtetas Shqiptar, lindur në Vlorë, më atë 21.07.1977, me numër personal H70721130E, në bazë të prokurës noteriale date 26.01.2022, me rep. n. 19654, që bashkëlidhet.
- Pala e lartpërmendur ka vendosur të nënshkruajë Statutin e mëposhtëm të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar, aktiviteti i së cilës rregullohet nga legjislacioni shqiptar në fuqi dhe nga ky Statut.

**KAPITULLI I**  
**FORMA, EMËRTIMI, OBJEKTI, SELIA, KOHËZGJATJA**

**Neni 1 – Forma**

- 1.1. Shoqëria "Tech Studio" Sh.p.k. (në vijim "Shoqëria") krijohet në formën e një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar, dhe veprimtaria e saj rregullohet me anë të këtij Statuti.
- 1.2. Shoqëria vepron sipas legjislacionit shqiptar në fuqi.
- 1.3. Statuti i shoqërisë është në përputhje me legjislacionin shqiptar që ka karakter të detyrueshëm, ndërsa çështjet që nuk janë shprehimisht të parashikuara në të, plotësohen nga legjislacioni shqiptar.

**Neni 2 – Emërtimi**

Emërtimi i Shoqërisë është "Tech Studio" Sh.p.k.

**Neni 3 – Objekti i shoqërisë**

- 3.1 Shoqëria ka për objekt kryerjen e aktiviteteve tregtare në përputhje me legjislacionin Shqiptar në fuqi.
- 3.2 Shoqëria ka si objekt kryesor:
  - a. Disenjim software-i duke përfshirë analizën e kërkesave të sistemit software, projektimin e arkitekturës dhe projektimin e detajuar të sistemit software;
  - b. Zhvillim dhe mirëmbajtje sistemesh software duke përfshirë programimin e sistemeve software, kodimin, instalimin, integrimin e të gjithë komponentëve, dokumentimin, identifikimin dhe korrigjimin e gabimeve, modifikimet (pas momentit që software-i është vendosur në operim), mirëmbajtja e të gjithë komponentëve, suporti i sistemit si një tërësi komponentësh, që, në funksionimin e tyre, realizojnë qëllimin e zgjidhjes informatike;
  - c. Testim software duke përfshirë testimin e funksionaliteteve, të ngarkesës në punë, të performancës, të pranimit, të disponueshmërisë dhe të sigurisë së sistemit software;
  - d. Disenjim dhe zhvillim sistemesh të komunikimit duke përfshirë analiza, planifikimin, projektimin, zbatimin, vendosjen në punë dhe mirëmbajtjen e sistemeve të komunikimit të rrjeteve të pajisjeve informatike (LAN/ WAN/ WLAN/ MAN/ SAN/ CAN);
  - e. Disenjim dhe zhvillim sistemesh të sigurisë duke përfshirë analiza të kërkesave të sigurisë së klientit, projektimin e arkitekturës, instalimet dhe konfigurimet e komponentëve, vendosjen në punë, testimet e sigurisë dhe mirëmbajtja përkatëse;
  - f. Zhvillim sistemesh migrimi duke përfshirë transferimin e të dhënave dhe

- g. Përmirësim/upgrade sistemesh informatike;
- h. Operimi, menaxhimi, suporti i përdorimit, trajnimi dhe auditimi teknik/informatik për sistemet softëare.

3.3 Shoqëria mund të kryejë çdo transaksion tregtar, industrial, financiar, me pasuri të luajtshme dhe të paluajtshme që konsiderohet i nevojshëm, i dobishëm apo i përshtatshëm, për arritjen e qëllimit të shoqërisë siç është specifikuar më sipër, duke përfshirë, por pa u kufizuar në, lëshimin e garancive dhe të garancive reale; lidhjen e kontratave të financimit të çdo lloji, edhe në formën e lisingut; lidhjen e kontratave të qiradhënies për asetet, pronat ose qiradhënie të të gjitha pjesëve të ndërmarrjes dhe/ose njësi të veçanta të saj që veprojnë në sektorët e lartpërmendur; blerjen, shitjen ose përdorimin e patentave të palëve të treta; marrja përsipër dhe dhënien e mandateve për agjenci, përfaqësi, agjent, koncesionar; dhe çdo aktivitet tjetër që here pas here mund të jetë konsideruar i nevojshëm, i dobishëm ose i përshtatshëm për qëllimet e mësipërme, në kufijtë e dispozitave ligjore në fuqi. Shoqëria mund të marrë pjesë në tenderë publik, shitje në ankand dhe gara private. Ajo mund të marrë përsipër, si drejtpërdrejtë ashtu edhe indirekt, interesa, kuota, pjesëmarrje dhe aksione, në shoqëri të tjera, shoqata, konsorciume ose ndërmarrje, që kanë për objekt, analog, të ngjashëm ose të lidhur me objektin saj në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi. Të gjitha këto aktivitete do të kryhen gjithsesi në kufijtë dhe në respekt të dispozitave ligjore që rregullojnë ushtrimin e tyre; në veçanti operacionet e natyrës financiare duhet të kryhen në respekt të plotë me dispozitat ligjore të kohës duke përjashtuar mbledhjen e fondeve në publik, në çfarëdo lloj forme.

#### Neni 4 – Selia

- 4.1. Selia e Shoqërisë është në Rruga Abdi Toptani, Torre Drin, Kati 2, 1001-Tiranë, Shqipëri.
- 4.2. Transferimi i selisë së Shoqërisë në një vend tjetër bëhet me vendimin e Asamblesë së Ortakëve.
- 4.3. Asambleja e Ortakëve mund të vendosë hapjen e filialeve, degëve dhe përfaqësive të Shoqërisë në qytete të tjera të Shqipërisë.

#### Neni 5 – Kohëzgjatja e veprimtarisë

- 5.1. Kohëzgjatja e veprimtarisë së Shoqërisë do të jetë me një afat të pacaktuar.

### KAPITULLI II KAPITALI THEMELTAR, KONTRIBUTET, NDARJA DHE TRANSFERIMI I KUOTAVE

#### Neni 6 – Kapitali themeltar

- 6.1. Kapitali themeltar i shoqërisë është ALL 254,000.00 (dyqindpesëdhjetëekatërmijë leke).
- 6.2. Kapitali themeltar i shoqërisë përbëhet nga 1 (nje) kuote, e nënshkruar, me vlerë nominale sipas kontributit të ortakut në kapitalin themeltar të Shoqërisë përcaktuar në nenin 7 (shtate) të këtij Statuti.

#### Neni 7 - Kontributet

- 7.1 Kontributi në kapitalin e shoqërisë është ofruar si më poshtë:
  - Shoqëria Grapho s.r.l ofron një kontribut në para të barabartë me ALL 254,000.00 (dyqindpesëdhjetëekatërmijë leke), nëpërmjet depozitimit të kësaj shume pranë llogarisë bankare në emër të shoqërisë në themelimin e sipër.
- 7.2 Sipas kontributeve të mësipërme:



- Shoqërisë Grapho s.r.l i përket një kuotë, me vlerë nominale ALL 254,000.00 (dyqindpesëdhjetëekatërmijë leke), që i korrespondon 100% (njëqind për qind) të kapitalit të Shoqërisë.

#### **Neni 8 – Rritja e kapitalit themeltar**

- 8.1 Kapitali themeltar mund të rritet pa kufi në çdo moment, një ose disa herë, me vendim të Asamblesë së Ortakëve.
- 8.2 Në rast rritjeje të kapitalit, të gjithë ortakët kanë të drejtën të nënshkruajnë rritjen në raport me vlerën nominale të kuotes së kapitalit të zotëruar. Në rast se disa nga ortakët nuk e ushtrojnë këtë të drejtë, pjesët e tyre mund të nënshkruhen nga ortakët e tjerë proporcionalisht me vlerën nominale të kuotes së kapitalit të zotëruar prej tyre.

#### **Neni 9 – Zvogëlimi i kapitalit themeltar**

- 9.1 Shoqëria mund të zvogëlojë kapitalin themeltar me vendimin e Asamblesë së Ortakëve. Në çdo rast kapitali themeltar nuk mund të zvogëlohet nën kufijtë e parashikuar nga ligji.
- 9.2 Zvogëlimi i kapitalit përballohet nga secili prej ortakëve në të njëjtën masë me vlerën nominale të kuotes së kapitalit të zotëruar prej tyre.

#### **Neni 10 – Transferimi i kuotave**

- 10.1 Kuotat janë lirisht të transferueshme ndërmjet ortakëve.
- 10.2 Në rast transferimi në çdo lloj forme, si me shpërblim ashtu edhe pa shpërblim në kuptimin më të gjerë të fjalës, duke përfshirë këtu edhe dhurimin në favor të subjekteve të tjerë të ndryshëm nga ortakët, kuotat duhet më parë t'i ofrohen në parablerje ortakëve të tjerë.
- 10.3 Në një rast të tillë ortaku që do të transferojë kuotën e tij duhet të njoftoj ortakët e tjerë, me letër rekomande me kthim përgjigje, mbi synimin për shitje, duke përcaktuar çmimin, kushtet, modalitetet, emrin e blerësit dhe afatet e transferimit. E drejta e parablerjes duhet t'i referohet të gjithë kuotes të ofruar për shitje.
- 10.4 Ortakët do të kenë në dispozicion 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga marrja e letrës rekomande, për t'i komunikuar ortakut që transferon kuotat, synimin e tyre për të ushtruar apo jo të drejtën e parablerjes. Në rast se ata nuk përgjigjen në afatin e caktuar, prezumohet se kanë hequr dorë nga e drejta e tyre e parablerjes.
- 10.5 Në rast se oferta pranohet nga disa ortakë, kuota e ofruar nga ortaku që transferon atë, do të ndahet midis ortakëve pranues, në të njëjtën masë me vlerën nominale të kuotes së kapitalit që ata zotërojnë, përveç rastit kur ka një marrëveshje të kundërt. Në asnjë rast, pranuesi i ofertës nuk mund të ushtrojë pjesërisht të drejtën e parablerjes.
- 10.6 Në rast se nuk ushtrohet e drejta e parablerjes, kuotat mund t'u transferohen të tretëve plotësisht apo pjesërisht, me vendimin pozitiv të Asamblesë së Ortakëve.
- 10.7 Në rast të transferimit të kuotave për shkak trashëgimie *mortis causa* ortakët e tjerë kanë të drejtë të shprehin pëlqimin e tyre për ortakët e rinj. Në rast se nuk jepet pëlqimi, kuotat mund t'u transferohen të tretëve plotësisht apo pjesërisht, me vendimin pozitiv të Asamblesë së Ortakëve me shumicë të thjeshtë.

### **KAPITULLI III ASAMBLEJA, ADMINISTRATORËT DHE EKSPERTI KONTABËL**

#### **Neni 11 – Asambleja e ortakëve dhe kompetencat e saj**

- 11.1 Organi vendim-marrës i Shoqërisë është Asambleja e Ortakëve.

- 11.2 Asambleja e Ortakëve është përgjegjëse për marrjen e vendimeve për çështjet vijuese: ndryshimet e statutit, emërimi e shkarkimi i administratorëve, ekspertëve kontabël e likuidatorëve, zmadhimi dhe zvogëlimi i kapitalit, transferimi i kuotave, shpërndarja e fitimeve, riorganizimi dhe prishja e shoqërisë, miratimi i bilancit dhe për çdo vendim tjetër parashikuar nga ky Statut apo nga legjislacioni përkates.

### **Neni 12 – E drejta e pjesëmarrjes dhe e votës**

- 12.1 Çdo ortak ka të drejtë të marrë pjesë në Asamble, të paraqesë mendimin e tij dhe të japë aq vota ne proporcion me vleren nominale te kuotes se kapitalit që ai zotëron.
- 12.2 Çdo ortak ka të drejtë të përfaqësohet nga një person tjetër jo-ortak, i pajisur me prokurë me shkrim, me anën e së cilës mund të japë votën e tij.
- 12.3 Ortaku nuk mund të lëshojë prokurë për votim për një pjesë të kapitalit që zotëron, në qoftë se voton personalisht për pjesën e mbetur.

### **Neni 13 – Thirrja e Asamblesë së Ortakëve, Kuorumi dhe Vendimet**

- 13.1 Asambleja e Ortakëve thirret të paktën një herë në vit, brenda gjashte muajve nga mbyllja e vitit financiar për miratimin e bilancit, të raportit të Administratorit, ekspertit kontabël si dhe inventarit.
- 13.2 Asambleja mund të thirret në çdo moment nga një prej Administratorëve sidhe prej një ose disa ortakëve që përfaqësojnë të paktën 5% (pesë përqind) të kapitalit themeltar. Asambleja duhet të thirret nëpërmjet njoftimit me letër rekomande me kthim përgjigje që duhet t'u dërgohet ortakëve – në adresën që rezulton sipas ketij Statuti – dhe ekspertit kontabël (nëse është emëruar), të paktën 7 (shtatë) ditë përpara mbledhjes së Asamblesë. Thirrja duhet të përmbajë informacion mbi llojin e Asamblesë, mbi çështjet që do të trajtohen dhe për të cilat do të merret vendim, mbi vendin, orën dhe datën e thirrjes së parë dhe të dytë.
- 13.3 Asambleja mund të thirret edhe jashtë selisë së Shoqërisë, veç në Itali ose në Shqipëri.
- 13.4 Në rast se Asambleja e Ortakëve nuk mbledhet me thirjen e parë për mungesën e kuorumit të parashikuar në pikën 13.7 e 13.8 te këtij Statuti, Asambleja e Ortakëve do të thirret brenda 30 (tridhjetë) ditësh me të njëjtin rend dite.
- 13.5 Mbledhjet e Asamblesë mund të mbahen edhe nëpërmjet telekonferencës dhe videokonferencës, me kusht që të gjithë pjesëmarrësit të mund të identifikohen dhe t'u lejohet atyre të ndjekin diskutimin dhe të ndërhyjnë në momenti n e trajtimit të çështjeve në rend të ditës; pasi të jenë verifikuar këto kërkesa që duhet të rezultojnë në procesverbalin e mbledhjes, Asambleja konsiderohet e mbajtur në vendin ku ndodhet Kryetari në të cilin duhet të ndodhet edhe Sekretari i mbledhjes.
- 13.6 Asambleja do të thirret dhe mbahet rregullisht edhe pa respektimin e formaliteteve të njoftimit, në rast se janë të pranishëm ortakët që përfaqësojnë të tërë kapitalin themeltar.
- 13.7 Vendimet e Asamblesë së Ortakëve, për të cilat kërkohet një shumicë e thjeshtë, janë të vlefshme nëse janë të pranishëm ortakët me të drejtë vote që zotërojnë më shumë se 30% (tridhjetë perqind) të kapitalit themeltar. Vendimet e Asamblesë së Ortakëve, të cilat kërkojnë shumicë të kualifikuar, janë të vlefshme nëse ka ortakë me të drejtë vote që përfaqësojnë të paktën 51% (pesëdhjetëenjë përqind) të të gjithë kapitalit themeltar.
- 13.8 Asambleja e Ortakëve vendos ndryshimet e statutit, zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit, shpërndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë, me votën pro të  $\frac{3}{4}$  (tre të katërtat) e ortakëve të pranishëm që zotërojnë të paktën 51% (pesëdhjetëenjë perqind) të kapitalit themeltar. Në të gjitha rastet e tjera, Asambleja e

Ortakëve merr vendime me shumicë të thjeshtë votash të ortakëve që zotërojnë më shumë se 30% (thridhjetë përqind) të kapitalit themeltar.

